



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:293114

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05586339

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli në çështjen penale ndaj të pandehurit N.B., me vendbanim në fshatin ..., komuna Shtime, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së) dhe veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1026/2023 të datës 28.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, i cili është mbajtur më datë 03.04.2024, në të cilin morën pjesë prokurori i shtetit Ardian Emini prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri N.B. me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Faton Neziraj, pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, më datë 03.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 17.04.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

N.B. nga i ati R. dhe nëna S., e gjinisë M., i lindur më datë ... në fshatin ..., komuna Shtime, ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, pensionist, me gjendje të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

-I-

Sepse:

Nga data e pavëtetuar e deri më datën 30 korrik të vitit 2023, në fshatin ..., Komuna Shtime, i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me Ligjin e aplikueshëm për armët të Republikës së Kosovës Nr. 05/L-022, pa autorizim ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paaautorizuar armët e zjarrit dhe atë një pistoletë me gaz e tipit “Ekol Special 99” kalibri 9mm, me numër serik EV-1..., prodhim Turk dhe një karikator i zbrazur, e cila i është sekuestruar nga ana e policisë, ku të njëjtën e ka mbajtur pa pasur leje nga organi kompetent.

-Me këtë ka kryer veprën penale **Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paaautorizuar të armëve** nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

-II-

Me datën 30 korrik të vitit 2023 rreth orës 17:29, në fshatin ..., Komuna e Shtimes, i pandehuri në kundërshtim me Ligjin e aplikueshëm për armët të Republikës së Kosovës Nr. 05/L-022, në atë mënyrë që si dasmor që ishte tek M.G., në shenjë gëzimi gjuan pesë herë në ajër me armë zjarri - armë me gaz, të tipit “Ekol Special 99” kalibri 9mm, e cila armë më pas i sekuestrohet të pandehurit nga ana e policisë si provë materiale.

- Me këtë ka kryer veprën penale **Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm** nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 42, 43, 47, 48, 49, 69, 70, 366 paragrafi 1 dhe 367 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452 dhe 455 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurin e:

G J Y K O N

- I. Për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind euro) të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa

II. Për veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht.

Të pandehurit, në kuptim të nenit 76 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.5 të KPRK-së, i shqipton:

D Ë N I M I N U N I K

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 € (pesëqind euro) të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjet) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, të njëjtit në pajtim me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguara, i pandehuri do të vuajë 1 (një) ditë burgim, dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet.
- III. Në bazë të nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, KONFISKOHEN 1 (një) një pistoletë me gaz e llojit me gaz e tipit “Ekol Special 99” kalibri 9mm, me numër serik EV-..., prodhim Turk dhe një karikator i zbrazur.
- IV. Obligohet i pandehuri në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej 20 (njëzet) euro, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm më datë 28.02.2024, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1026/2023, kundër të pandehurit N.B., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-

së dhe veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me datë 03.04.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit Ardian Emini prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri N.B. me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Faton Neziraj, avokat nga Ferizaj.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohet dhe ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-së, andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-së, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore të cilat kërkojnë me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve të cilat ishin prezentë.

Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit dhe i njëjti nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë. Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: Raporti i oficerit i datës 30.07.2023, Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve me numër 2023-AU-238, i datës 30.07.2023, Deklarata e dëshmitarit B.B. e dhënë në polici me datë 30.07.2023, Deklarata e të pandehurit N.B. e dhënë në polici më datë 30.07.2023, Zinxhiri i ruajtjes, i datës 30.07.2023, 2 (dy) fotografi të formatit A4 si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë, po ashtu me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban

asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike lidhur me veprat penale për të cilat i pandehuri e ka pranuar fajësinë.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri N.B., ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi ti shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind euro) ndërsa për veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen veprën tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht, andaj të pandehurit i është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen veprën tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht dhe dënim me gjobë, në shumën prej 500 € (pesëqind euro) të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë: pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, është hera e parë që kryen veprën penale, faktin se i njëjti është përdorur për veprat penale që i ka kryer, mosha e vjetër e të pandehurit, premtimin që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi për konfiskimin e armës

Neni 366 paragrafi 3 i KPRK-së përcakton se: “Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet”. Andaj, gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore vendosi që të konfiskohen 1 (një) pistoletë e llojit me gaz e llojit me gaz e tipit “Ekol Special 99” kalibri 9mm, me numër serik EV-1..., prodhim Turk dhe një karikator i zbrazur.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimin shumën prej 20 (njëzet) Euro.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2024:067400, me datë 17.04.2024

Zyrtarja Ligjore,
Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.